17/05/2024

# TEATRI INTERAKTIV DHE LETERSIA GREKE



Më 27/04, në sallën Arbo në Athinë, u zhvilluan dy shfaqje teatrale bazuar në tre tregime të Aleksandros Papadiamantis (“Pa kurorë”, Pagëzimi i fundit”, “Një shpirt”), me karakter interaktiv. Në këtë projekt teatror me titullin “Kthehu”, marrëdhënia tradicionale mes skenës dhe publikut ndryshon rrënjësisht, si në përmbajtje ashtu edhe në formë. Një proces krejtësisht ndryshe shfaqet, që siguron një ndërveprim emancipues për shikuesit, me qëllim krijimin e kuptimeve të tyre. Përvoja e të gjithëve integrohet në një mjedis hulumtues inovativ, ku gjatë shfaqjes teatrale një interpretues – ndoshta regjisori – ndërhyrë midis aktorëve, personazheve dhe shikuesve. Këta të fundit nuk janë thjesht spektatorë të palëvizshëm, por janë gati të përgjigjen ndaj realitetit të shfaqjes.

Bazuar në tematikat e tre tregimeve (vdekshmëria e fëmijëve dhe pozicioni social i grave në shoqërinë greke në të kaluarën). U shfaqën pyetjet të mëposhtme si pikëpamje thelbësore për reflektim, për kontribuesit e performancës, lidhur me interaksionin me audiencën: Për çfarë arsyeje vlen të paraqitet në teatër një histori e vjetër? Në çfarë shkalle kronologjikisht largësia është edhe kulturoralisht ndryshe? Çfarë lidhjesh kuptimore mund të përmbajnë në nevojën tonë për “kthimin” të një personi të dashur kur ka ndodhur fundi përfundimtar- vdekja? Si

formohet ndjenja dhe kujtesa pas humbjes përfundimtare?

Nga studimi i pyetësorëve të shpërndarë, nga komentet dhe vërejtjet e publikut, si dhe nga rishikimi kritik i paraqitjeve të regjistruara dhe reflektimi nga bashkëpunëtorët, pritet të kristalizohen qëndrime për përmirësimin e mëtejshëm të metodës.

Regjisori i shfaqjes ishte Simos Papadopulos, Asistent Profesor në Universitetin Demokrit të Thrakës, Lina Basoukou, pedagoge në Programin e Gjuhës dhe



e aktore, interpretoj tregimet
jes dhe publikut u mor nga
natografinë dhe montazhin e
lis.





Kolegji Universitar Logos